

Veriu i Kosovës dhe marrëdhëniet Prishtinë-Beograd

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) më 26-27 qershor të vitit 2014, ka organizuar në Stamboll të Turqisë një tryezë të rrumbullakët për përfaqësuesit e partive politike dhe shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia. Diskutimi ka adresuar çështjen e krijimit të institucioneve lokale në veri të Kosovës, si dhe normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit. Në takim kanë marrë pjesë përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizjes Vetëvendosje (VV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), si dhe qeverisë së Kosovës dhe zyres së Presidentes; dhe përfaqësues të Partisë Progresive Serbe të Serbisë (SNS), Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), Partisë së Re Demokratike (NDS), dhe një zyrtar nga Zyra për Kosovë në qeverinë e Serbisë. Pjesëmarrës poashtu kanë qenë një numër analistësh nga Kosova e Serbia.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, të financuar nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme.

Dita e parë e diskutimit ka qenë e fokusuar në krijimin e institucioneve lokale në katër komunat e veriut, dhe marrëdhëniet e tyre me institucionet qendrore të Kosovës. Pjesëmarrësit kanë renditur një numër pengesash të cilat janë duke e vonuar krijimin e institucioneve komunale. Shumë folës shqiptarë të Kosovës e kanë bërë Beogradin përgjegjës për vonesat, e jo kryetarët e komunave në veri. Kryetarët e komunave janë zgjedhur në pajtim me ligjet e Kosovës, por ata ende mbesin në pozicionet e tyre kundër integritimit në sistemin e Kosovës, duke thënë se zgjedhjet në të cilat ata kanë marrë pjesë kanë qenë “neutrale ndaj statusit”, dhe së këndejmë, edhe institucionet lokale do të duhej të ishin neutrale ndaj statusit.

Rrjedhimisht, folësit shqiptarë të Kosovës kanë thënë se Beogradi është fajtori kryesor për “mosrrespektimin” e marrëveshjes së Brukselit. Ata kanë propozuar që komuniteti ndërkombëtar do të duhej të ushtronte më shumë tryzni mbi Beogradin, e jo mbi përfaqësuesit lokal në veri, për shkak se “ata thjesht zbatojnë vendimet e Beogradit”. Shumë nga folësit serbë nuk janë pajtuar, duke thënë se problemi është poashtu tek Prishtina. Ata kanë thënë se qeveria e Kosovës nuk është e gatshme të bëjë çfarëdo kompromisi, as edhe rreth çështjeve teknike, siç janë simbolet dhe statutet komunale, të cilat kanë marrë me muaj të tërë që të zgjidhen. Megjithate, të dyja palët i kanë bërë thirrje Bashkimit Evropian që të përfshihet më shumë në procesin e implementimit.

Dita e dytë e diskutimeve ka adresuar çështjen e dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit. Shumica e folësve kanë thënë se dialogu duhet të vazhdojë dhe të fokusohet në

implementimin e marrëveshjeve të kaluara dhe në arritjen e marrëveshjeve të reja. Disa përfaqësues shqiptarë të Kosovës kanë qenë kundër vazhdimit të dialogut në formatin e tanishëm, duke thënë se Kosova nuk është trajtuar si shtet, dhe se vetëm Serbia ka përfituar nga dialogu. Ata kanë thënë se nëse partitë e tyre politike formojnë qeverinë e re, dialogu do të vazhdojë, por me një format tejtër, dhe sipas të gjitha gjasave, me disa kushte. Pjesëmarrësit i kanë bërë thirrje Bashkimit Evropian që të marrë më shumë përgjegjësi në këtë proces, dhe të të shërbejë jo vetëm si lehtësues i diskutimeve por edhe si monitorues dhe zbatues i marrëveshjeve. Bashkimi Evropian do të duhej poashtu të jetë i gatshëm të ofrojë interpretim të marrëveshjeve të arritura kur paraqitet nevoja.

Më poshtë është një përmbledhje nga tryeza e rrumbullakët. Me qëllim të inkurajimit të një diskutimi të hapur dhe të sqartë, nuk janë atribuar folësit specifik. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në tryezë në kapacitetet e tyre personale dhe pozicionet e tyre jodomosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e organizatave të cilat ata i përfaqësojnë.

Krijimi i institucioneve lokale në veri

Në mesin e pjesëmarrësve ka pasur konsensus se marrëveshja e Brukselit nuk është duke u implementuar sipas afateve të përcaktuara. Por, përderisa pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë fajësuar Beogradin, kryetarët e rinjë të komunave, dhe institucionet paralele të mbetura në veri, siç janë të ashtuquajturat mbrojtja civile dhe zyret ekzekutive komunale “të përkohshme” të Serbisë, folësit serbë kanë thënë se Prishtina e ka bllokuar procesin duke mos pasur vullnet të bëjë kompromiset e nevojshme në mënyrë që të shkohet më tutje me implementimin.

Një pjesëmarrës ka raportuar se çështja e simboleve dhe statuteve komunale është zgjidhur dhe se komunat pritet të marrin buxhetet e tyre nga qeveria. Të hyrat komunale në Kosovë janë shumë të vogla, e kjo vlen sidomos për veriun, ku nuk janë duke u mbledhur taksat, dhe për këtë arsye komunat para së gjithash mbështeten në grantet e qeverisë. Për momentin, komunat veriore të Kosovës nuk kanë burime të pavarura financiare; ato janë subvencionuar nga Beogradi, por marrëveshja e Brukselit bën thirrje për ta përmbyllur në mënyrë graduale një financim të tillë. Autoritetet lokale në veri duhet ta gjejnë një mënyrë për zgjidhjen e çështjes së financimit të ndërmarrjeve publike në territoret e tyre, pasi që kjo do të ishte e pamundur të bëhet përmes një buxheti të zakonshëm komunal të Kosovës. Në mënyrë që të mbijetojnë dhe të jenë të suksesshme, këto ndërmarrje do të duhet të operojnë në bazë të rregullave të tregut të lirë.

Implementimi i marrëveshjeve, sipas një analisti, është duke u vonuar për shkak se askush nuk është në nguti. Për më shumë, transferimi i fuqisë nga një palë institucione në institucione tjera është proces i komplikuar, edhe atëherë kur bëhet mes institucioneve të cilat janë miqësore ndaj njëra tjetrës. Pjesëmarrësit kanë raportuar një numër pengesash politike dhe teknike. Pengesat teknike janë të ngjajshme me ato me të cilat janë ballafaquar komunat tjera me shumicë serbe në jug të Kosovës gjatë formimit të tyre, por problemet politike janë më të ndërlikuar. Kjo rrjedh nga fakti se formimi i komunave në veri bazohet në një marrëveshje të shtyrë nga interesat nacionale të Serbisë dhe Kosovës,

e jo nga nevoja për zgjidhjen e mosmarrëveshjes rreth veriut dhe normalizimit të gjendjes në terren.

Një folës ka thënë se marrëveshja e Brukselit ka qenë rezultat i ambicieve të Serbisë për të bërë përparim drejt BE-së, dhe dinamika me të cilën do të ecë implementimi do të jetë e lidhur si dhe do të varet nga shpejtësia me të cilën Serbia do të bëjë përparim drejt anëtarësimit. “Beogradi do të ndërmarrë hapa pozitivë kur të jetë afër që të marrë diçka, si p.sh. statusin e kandidatit apo datën për fillimin e negociatave nga Brukseli”. Një tjetër folës ka theksuar se kryetarët e komunave në veri nuk janë problemi, duke shtuar se “kryetarët e komunave janë duke bërë cdo gjë që kërkohet nga ta; ata nuk janë në pozitë ta kundërshtojnë Beogradin, edhe nëse do të dëshironin ta bënin në gjë të tillë”. Ai ka konkluduar duke thënë se burimi, dhe në të njëjtën kohë zgjidhja e problemit është në Beograd, dhe se komuniteti ndërkombëtar do të duhej ta shtonte trysninë ndaj Beogradit në mënyrë që të rrespektohen afatet për implementimin e marrëveshjes së Brukselit.

Një folës i afërt me aspektet teknike të krijimit të komunave ka treguar për rezultate të dobëta rreth implementimit. Ai ka thënë se komunat e veriut përdorin vetëm rreth 7 përqind të buxhetit të tyre, që shënon një rritje prej 2 për qind që ka ekzistuar në muajin e kaluar. Pengesat për marrjen e buxheteve, siç janë statutet dhe simbolet, janë eliminuar, por kryetarët e komunave duket sikur nuk janë të gatshëm të pranojnë fonde nga institucionet e Kosovës. Ai ka treguar se kryetarët e komunave janë duke ndërmarrë hapa shumë të vegjël dhe të kujdesshëm drejt integritimit. “Aq hapa të vegjël sa të mos shihen si pranim i institucioneve të Kosovës, dhe aq të mëdhenj sa mos ta çënojnë haptazi ligjin që do të rezultonte në zgjedhje tjera lokale”.

Një tjetër pjesëmarrës ka kërkuar nga qeveria e Kosovës që të ofrojë mbështetje teknike për komunat në veri, duke thënë se nevojitet një lloj asistence në mënyrë që tu ndihmohet komunavë ta kuptojnë se si të funksionojnë brenda sistemit të Kosovës dhe në pajtim me ligjet e Kosovës, të cilat janë mjaft të ndryshme nga ato të Serbisë.

Një folës nga veriu ka thënë se edhe hapat e vegjël janë joekzistent. “Komunat e Kosovës nuk funksionojnë aspak, dhe të gjithë e dijmë këtë, dhe asnjë shërbim i vetëm lokal nuk ofrohet nga to”. Megjithatë, është raportuar se shërbimet vazhdojnë të ofrohen nga institucionet e Serbisë. Ky folës ka shtuar se zgjedhjet parlamentare nuk kanë qenë të rregullta, dhe se ato “kanë qenë të manipuluar nga [ish ministri serb përgjegjës për Kosovën dhe ministri i tanishëm serb i punës, punësimit, veteranëve dhe politikave sociale] Aleksandar Vulin, me bekimin paraprak të kryeministrit serb, Aleksandar Vucic”. Ai ka shtuar se kryetarët e komunave të veriut dhe zyrtarët tjerë të zgjedhur, nuk brengosen për qytetarët e tyre, për faktin e thjeshtë se ata nuk janë elektorati i tyre. Këta zyrtarë janë zgjedhur nga Serbia dhe ata e shohin qeverinë e Serbisë si votuesin e tyre primar, duke u pergjigjur kështu vetëm në urdhërat që vijnë nga Beogradi. Ai ka thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë më i rreptë me Beogradin dhe zyrtarët lokalë në veri. Ai ka treguar se as asamblatë komunale nuk janë duke funksionuar. “Asamblatë lokale nuk mbajnë mbledhje; ndonjëherë kanë mbledhje vetëm me kryetarët e komunave dhe Vulinin”, pra nuk ekziston kurrfarë funksionimi institucional. Nuk ka komunikim mes kryetarëve të komunave dhe qytetarëve. Qytetarët nuk e dijnë se për çfarë janë

përgjegjës kryetarët e komunave. “Le të mos shtiremi sikur nuk dijmë asgjë, sikur çdo gjë është në rregull”, ka konkluduar ky folës.

Një numër i folësve kanë thënë se arsyeja prapa rezultateve të dobëta në veri është mungesa e qartësisë së marrëveshjes së Brukselit. Por një folës tjetër ka thënë se marrëveshja e Brukselit është shumë e qartë. “Ajo është e paqartë vetëm për ata të cilëve kjo marrëveshje nuk ju pëlqen”. Ai ka shtuar se arsyeja pse komunat nuk janë duke funksionuar është për shkak se ata të cilët janë përgjegjës, nuk janë të interesuar që ato të funksionojnë, dhe jo pse nuk e kanë të qartë se si ti formojnë ato. “Ne po vazhdojmë ta gënjejmë njëri tjetrin, të nënshkruajmë marrëveshje, dhe një vit më vonë nuk i kemi as elementet më bazike, siç janë statutet e komunave”, ka thënë një folës. Ai e ka fajësuar Beogradin për mungesën e përparimit në veri, por edhe Prishtinën për mosgatishmërinë e saj për të implementuar shumë gjëra që janë në planin e Ahtisaarit. Ai ka theksuar se bazuar në përvojën e tij në jug, krijimi i komunave është çështje politike, e jo teknike. “Çështjet teknike mund të zgjidhen brenda një dite”. Ai ka propozuar që serbët ta përgatisin statutin për Asociacionin e Komunave, mandatin e tij, t’i qartësojnë përgjegjësitë, dhe t’i identifikojnë burimet e financimit. Ai ka shtuar se Prishtina do të duhej gjithashtu t’u jepte më shumë përgjegjësi dhe fonde komunave veriore, porse edhe kryetarët e komunave në veri duhet ta dijnë dhe ta pranojnë faktin se ata janë kryetarë të komunave të Kosovës.

Edhe pse ishin ftuar në këtë tryezë të rrumbullakët, dhe njëri prej tyre kishte konfirmuar pjesëmarrjen, asnjëri nga kryetarët e komunave të veriut nuk kishte ardhur në këtë tryezë. Një folës ka thënë se ata duhet të marrin pjesë në forume të tilla, dhe të shpjegojnë vështirësitë që kanë në lidhje me funksionalizimin e komunave, dhe jo “thjesht të barrikadohen kundër çdo iniciative”. Ai ka thënë se Beogradi duhet t’u lejojë institucioneve lokale që të bashkëpunojnë me Prishtinën dhe të fillojnë të ofrojnë shërbime. Në lidhje me Asociacionin e Komunave, ai ka thënë se është thjesht bashkëpunim ndërkomunal i cili nuk u jep të drejta të reja komunave. Kryetarët e komunave do të mbesin akterët kryesor dhe me më së shumti përgjegjësi.

Largimi i barrikadës në Mitrovicë, dhe ribllokimi i urës me një “park” është përmendur poashtu nga pjesëmarrësit gjatë diskutimeve. Një folës ka thënë se barrikada apo parku nuk ka të bëjë me përmirësimin e të drejtave, por ndihmon në ngritjen e tensioneve, me qëllim të “mbajtjes së fokusit të njerëzve tek patriotizmi”. Nëse do të largoheshin tensionet, njerëzit do të kërkonin vende pune, shkollim dhe shëndetësi më të mirë. “Tensionet dhe patriotizmi i ushqen njerëzit dhe u mundëson udhëheqësve politik të vazhdojnë të kenë një jetë të mirë.” Duke folur për mungesën e fondeve për komunat e veriut, ky folës ka thënë se nuk mund tu jepen para komunave të cilat ende nuk janë formuar dhe nuk funksionojnë. Sjellja e qeverisë së Serbisë nuk është e qartë. Ky folës ka shtuar se ende mbetet e paqartë nëse Serbia e ka nënshkruar marrëveshjen vetëm për ta marrë statusin e kandidatit të BE-së dhe datën e fillimit të negociatave, apo nëse është me të vërtetë e interesuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ai ka parashikuar se institucionet në veri nuk do të fillojnë të integrohen për aq kohë sa të vazhdojnë të marrin para nga Beogradi.

Pjesëmarrësit kanë konkluduar se kryetarët e komunave në veri duhet t'i nominojnë drejtorët e tyre komunal, ti kompletojnë detyrat e mbetura administrative në mënyrë që t'i marrin buxhetet e tyre, t'i krijojnë administratat komunale, t'i zgjidhin çështjet ende të hapura rreth simboleve, ta hartojnë së bashku një strategji të zhvillimit, si dhe të fillojnë implementimin e projekteve.

Normalizimi i marrëdhënieve

Dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit ka ngecur për shkak të zgjedhjeve, që janë mbajtur së pari në Serbi, e pastaj edhe në Kosovë. Shumë prej akterëve presin që dialogu do të vazhdojë pasi që Kosova ta formojë qeverinë e re, por shumë pak prej tyre e dinjë se çfarë çështje të reja do ti adresojë dhe në çfarë formati. Qeveria e Serbisë thotë se është e gatshme ta vazhdojë dialogun. Por kritikët e drejtojnë gishtin kah mungesa e progresit në implementimin e marrëveshjes së Brukselit. “Beogradi është gjithmonë i gatshëm të nënshkruajë marrëveshje, sepse e di se nuk duhet t'i implementojë ato”, ka thënë një folës.

Partitë politike të Kosovë janë poashtu për vazhdimin e dialogut, por në një format tjetër dhe disa prej tyre, si Lëvizja Vetëvendosje, insistojnë në një numër kushtesh për Serbinë. Një folës ka thënë se dialogu i Brukselit ka prodhuar vetëm kriza dhe tensione. Sa i përket veriut, “dialogu ka qenë një katastrofë”, ka argumentuar njëri nga folësit. Një tjetër folës ka shpjeguar se edhe pse partia e tij e ka përkrahur dialogun, ajo nuk është e kënaqur me rezultatet e tij, duke shtuar se, nëse do të jenë në pushtet, partia e tij do ta ndryshojë formatin e dialogut dhe do ta ndërlihdë atë me implementimin. “Çfarë të mirë sjellin marrëveshjet të cilat nuk zbatohen?”. Folësit nga Kosova kanë thënë se dialogu i ardhshëm do të duhej të merrej vetëm me marrëdhëniet ndërshtetërore, e jo me çështjet e brendshme të Kosovës. Një tjetër folës ka thënë se Brukseli duhet t'i bëjë trysni Beogradit që të jetë më konstruktiv, dhe ta heq Kosovën nga kushtetuta e tij. “Është e vështirë të kemi dialog të vërtetë me dikë që pretendon se toka jote është e tij”.

Komuniteti ndërkombëtar vazhdon ta mbajë barrën e ndërmjetësuesit mes Kosovës dhe Serbisë. Edhe pse shumica e folësve kanë propozuar një përfshirje më intenzive të komunitetit ndërkombëtar në dialog dhe në procesin e implementimit, disa prej tyre kanë qenë skeptik se një përfshirje e tillë do të prodhonte më shumë rezultate, duke pasë parasysh “pozitën e dobësuar kushtëzuese të BE-së ndaj Serbisë”, tani që Serbia vetëm ka filluar procesin e negociatave. Megjithatë, disa kanë thënë se BE-ja duhet të jetë garantuesi formal i implementimit të marrëveshjeve, dhe “mos ta lë implementimin në vullnetin e qeverive në Prishtinë e Beograd”.

Përkundër implementimit të ngadalshëm, një grup folësish kanë thënë se marrëveshja e Brukselit ka qenë një “hap i madh, ndoshta i dobët, por megjithatë i madh”, duke pasë parasysh rrethanat në të cilat është arritur marrëveshja. Shumë gjëra të cilat kanë qenë të paimagjinueshme vetëm disa muaj para arritjes së marrëveshjes, janë bërë të mundshme me anë të marrëveshjes. Një folës ka thënë se ndoshta disa njerëz kanë pasur pritje shumë më të mëdha të cilat, natyrshëm kanë rezultuar me pakënaqësi në lidhje me procesin. “Thjesht nuk është realiste të pritët që Serbia do t'i ndihmojë Kosovës me anëtarësimin

në Kombet e Bashkuara, apo në lidhje me njohjen nga pesë shtetet anëtare të BE-së”. Përderisa folësit kanë thënë se duhet të bëhen përpjekje për të përmirësuar procesin, ata kanë pranuar se megjithatë është më mirë të ketë marrëveshje të dobëta, sesa të mos ketë fare marrëveshje.

Një pjesëmarrës ka propozuar që Prishtina do të duhej ta bënte prioritet “normalizimin e Kosovës”, para se të merrej me normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Qytetarët e Kosovës ballafaqohen me një numër sfidash ekonomike, kurse qeveria e Kosovës shpenzon pjesën dërrmuese të kohës duke u marrë me Serbinë. Për më shumë, një folës ka thënë se BE-ja nuk ka qenë e drejtë me Kosovën, duke i dhënë Serbisë datën e fillimit të negociatave vetëm pse e ka nënshkruar marrëveshjen, marrëveshje të cilën nuk e ka implementuar.

Përfundim

Mosmarrëveshja rreth veriut është pasqyrim i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Në kërkesën që ta paraqesë funksionalitetin e komunave të veriut në formë të përqindjeve, një folës ka thënë se këto komuna funksionojnë rreth 7 përqind, pasi që shfrytëzojnë vetëm 7 përqind të buxheteve të tyre. Ai ka shtuar se kjo përqindje pasqyron përmirësimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, duke qenë se para dialogut të Brukselit kjo përqindje ka qenë afër zeros. Një tjetër folës ka theksuar se nëse veriu shikohet si një çështje e izoluar, atëherë nuk do ta shohim çështjen në kontekst më të gjërë. Shumica e pjesëmarrësve kanë thënë se Beogradi është adresa kryesore ku duhet të drejtohen të gjitha ankesat potenciale në lidhje me mosimplementimin e marrëveshjes së Brukselit, e jo kryetarët e komunave në veri.

Pjesëmarrësit kanë qenë në favor të një udhëheqësie më autonome dhe kompetente në veri. Beogradi ka mikromenaxhuar skenën politike lokale në veri për një kohë shumë të gjatë, duke krijuar kështu varshmëri, e cila do ta dëmtojë zhvillimin e rajonit. “Parku i paqes” i ndërtuar në urën e Mitrovicës, nga folësit shqiptarë të Kosovës është konsideruar si hap prapa në këtë proces, kurse pjesëmarrësit serbë kanë thënë se ky është një hap para. Shumë pjesëmarrës serbë ka thënë se Prishtina duhet të tregojë më shumë gatishmëri për të arritur kompromis në lidhje me formimin e institucioneve të reja në veri.

Diçka që është përmendur përsëri edhe në këtë diskutim ka qenë se komunat në veri nuk shohin kurrfarë interesi apo përparësie sa i përket integritet në sistemin e Kosovës. Për më shumë, ata poashtu nuk e kanë përshtypjen se Prishtina është me të vërtetë e interesuar për integrimin e tyre.

Shumë nga pjesëmarrësit nuk kanë qenë të kënaqur me rezultatet sa i përket normalizimit të marrëdhënieve përmes dialogut të Brukselit dhe marrëveshjeve pasuese. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ka pritur që marrëveshja do të implementohej në kohë. Përdersia pjesa më e madhe e folësve kanë thënë se dialogu do të mund të organizohej në një format tjetër, ata megjithatë më shumë e kanë përkrahur vazhdimin e një procesi me hapa të vegjël, sesa zhvendosjen e fokusit në kërkim të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse.

Lista e pjesëmarrësve

Illir Deda, Anëtar, Lëvizja Vetëvendosje

Jelena Djokic, Këshilltare e Kryetarit të Komunës së Zvecanit

Sadri Ferati, Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, Lidhja Demokratike e Kosovës

Ardian Gjini, Zëvendëskryesues, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Adrijana Hodzic, Zyrtare Kryesore Ekzekutive, Zyra Administrative në Mitrovicë Veri

Dusan Kozarev, Ndihmës Drejtor i Zyrës për Kosovë dhe Metohi, Qeveria e Serbisë

Leon Malazogu, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Demokraci për Zhvillim

Ljubisa Mijacic, Këshilltar i Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut

Petar Miletic, Ish-nënkryetar, Parlamenti i Kosovës

Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal të Kosovës

Krstimir Pantic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

Lulzim Peci, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Dejan Radenkovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

Nenad Radosavljevic, Drejtor i Bordit, Rrjeti i TV stacioneve serbe në Kosovë

Branko Ruzic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

Besa Shahini, Analiste e Lartë, Iniciativa Evropiane për Stabilitet

Jelena Trivan, Drejtoreshë, Qendra për Politika dhe Vlera Evropiane

Janko Veselinovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia e Re Demokratike

Arber Vllahu, Shef i Kabinetit të Presidentes së Kosovës

Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Alex Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Jean-Luc Oesch, I ngarkuar me Punë, Ambasada e Zvicrrës në Serbi

Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrrës